

KDU 376.091 (496.51) (091)

Ma. Saranda SHATRI**ZHVILLIMI I ARSIMIT SPECIAL NË KOSOVË***Fillet e arsimit special në Kosovë*

Edukimi dhe arsimit special daton nga gjysma e shekullit XIX kur formohen entet e para edukative-arsimore për fëmijët me të meta në zhvillim fizik dhe psikik.¹ Institucionet e para të edukimit special kishin karakter filantropik, mëshirues dhe kishin për qëllim që të informonin opinionin për mundësitë e arsimit, të edukimit dhe të aftësisimit për punë të fëmijëve dhe të rinjve me të meta fizike dhe psikike. Për këtë qëllim, në ish-Jugosllavi hapën shkollat e para, së pari për fëmijë të verbër dhe pastaj për shurdhmemecë, në mbarim të shekullit XIX si në Goricë, në Mitrovicë të Sremit, në Zagreb, në Beograd, në Lublanë, në Zemun etj. Deri në vitin 1958 as në nivel të Jugosllavisë (kuptohet edhe në Kosovë) nuk ishte përcaktuar me ligj çështja e arsimit special. Tek prej këtij vitit arsimit fillor tetëvjeçar bëhet i obligueshëm, në kuadër të saj edhe arsimit fillor special. Në vitin 1963 hapet Shkolla e parë e Lartë Defektologjike (katërvjeçare) në Zagreb kurse në Beograd në vitin 1975 hapet Fakulteti Defektologjik, në të cilat bëhet përgatitja profesionale e mësimdhënësve të ardhshëm në shkollat speciale në tërë territorin e Jugosllavisë.² Në këto fakultete bëhet përgatitja e mësimdhënësve për shkollat speciale edhe për mësimdhënësit të nxënësve shqiptarë, por numri i tyre atëherë dhe sot është i vogël në krahasim me nevojat e shkollave dhe të paraleleve speciale të Kosovës. Në Kosovë deri në gjysmën e dytë të shekullit XX nuk kishte asnjë shkollë speciale. Deri në këtë kohë të gjithë të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës, të cilët ishin të interesuar për të vijuar shkollimin mund të arsimoheshin vetëm në shkollat speciale në Serbi. Numri i të rinjve nga Kosova të interesuar për t'u shkolluar në Serbi ishte shumë i vogël, sidomos nga radha e shqiptarëve, sepse në Serbi ata e ndienin vetën si të huaj aq më tepër kur edhe nuk e dinin gjuhën serbe. Kjo vlen sidomos për fëmijët me pengesa në të pamur. Fëmijët (dhe prindërit) shqiptarë nuk kishin motiv për t'u arsimuar në shkollat speciale jashtë Kosovës, meqë edhe punësimi i tyre pas mbarimit të shkollimit, gati ishte i pamundur.

1 Grup autorësh. Pedagoska enciklopedija 2. botim i përbashkët i të gjitha ish-republikave të Jugosllavisë. Zagreb, Beograd, Novisad, 1989. fq. 376

2 Po aty, fq. 377

Përpjekjet për hapjen e shkollave speciale në Kosovë ishin të pareshtura, por çelja e shkollave të tilla në Kosovë kishte pengesa të shumta. Së pari nuk kishte infrastrukturë për hapjen e shkollave speciale për numër të vogël të fëmijëve që do të përfshiheshin në to dhe askush nga pushtetarët dhe udhëheqësit e arsimit nuk kishin treguar ndonjë interesim, nuk kishte ligj adekuat për shkollat speciale, me të cilin do të obligoheshin organet e arsimit që të jenë më këmbëngulës për hapjen e tyre, personeli mësimor-edukativ në gjuhën shqipe mungonte tërësisht dhe nuk kishte asnjë defektolog, tiflopedagog, logopedë etj. Ishte logjike që edhe tekste mësimore nuk kishte meqë edhe nuk kishte nxënës. Nxënësit që kishin pengesa në të pamur do të duhej të mësonin sipas alfabetit të Brajrit, kurse ky alfabet u përshtat dhe modifikuar në gjuhën shqipe tek në vitin 1965.

Meqë Ministria e Arsimit nuk merrej me çështjen e arsimit dhe të edukimit të fëmijëve me pengesa në zhvillim, iniciativën për hapjen e tyre e morën shoqatat përkatëse: Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe Shoqata e Shurdhmemecëve të Kosovës.³ Me iniciativën e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, në Mitrovicë në vitin 1950 hapët konvikti për fëmijë të verbër. Këta fëmijë ishin të sistemuar në konvikt me një numër të kufizuar.

Derisa në Kosovës nuk kishte asnjë shkollë speciale në republikat e ish-Jugosllavisë kishin një traditë relativisht të gjatë për këto tipe të shkollave. Në vitin shkollor 1950/51 në republikat e ish-Jugosllavisë kanë vepruar 37 shkolla speciale në të cilat ishin të përfshirë 2.920 fëmijë në 52 paralele, ndërsa në Kosovë nuk kishte asnjë shkollë të tillë, me përjashtim të Mitrovicës ku ishte hapur në këtë vit një gjysmëshkolle, konvikt ku ishin sistemuar fëmijët, të cilët edhe ndiqnin ndonjë zeje.

Rrjeti i shkollave speciale sipas disa viteve ishte si më poshtë:⁴

Vitet shkollore	1952/53	1957/58	1965/66
Rrjeti i shkollave	1	2	3
Numri i nxënësve	28	70	137
Nr. mësimdhënësve	2	8	13

Konvikti me një lloj shkolle speciale është hapur në Mitrovicë edhe për fëmijë me pengesa në dëgjim në vitin 1950 dhe është transferuar në Prizren vetëm pas një viti, në vitin 1951/52. Pra, zanafilla e shkollave të para speciale fillon në Mitrovicë si për fëmijë me pengesa në dëgjim ashtu edhe për ata të verbër.

3 Stanislav Stavretoviq & dr. Gjorgje Stavretoviq, Razvoj skolstva za gluve na Kosovu i Metohiji, revista serbe e IHK, Kosmet 1, Prishtinë, 1991

4 Pokrajinski sekretarijat za obrazovanje i kulturu, Statisticko-dokumentaciona osnova ostvarenog razvoja obrazovanja i kulture u APKM, Pristina, 1968, fq. 14

Në vitet e gjashtëdhjeta krahas shkollave speciale hapën edhe paralele speciale në kuadër të shkollave të rregullta fillore.

Në vitin Shkollor 1960/61 në Prishtinë në kuadër të shkollës fillore "Vuk Karagjiqi" (tani "Elena Gjika") ishin hapur paralelet e nxënësve me pengesa në dëgjim. 17 nxënës ishin të përfshirë në 2 paralele. Vijues të këtyre paraleleve ishin nxënësit e Prishtinës me rrethinë. Themelues dhe financues i këtyre paraleleve ishte Kuvendi i Komunës. Procesi mësimor është organizuar vetëm në gjuhën serbe, kurse në gjuhën daton shqipe prej vitit Shkollor 1966/67 me mësuese Nazmije Krasniqi. Gjenerata e parë e nxënësve që e kanë kryer klasën VIII ka dalur në vitin shkollor 1977/78.⁵

Paralelet speciale për fëmijë të retarduar në kuadër të shkollave fillore për herë të parë janë formuar në vitin shkollor 1966/67 në shkollën fillore "17 Nëntori" në Prizren dhe ky ishte fillimi i punës së këtillë edukative-arsimore. Pas plot 7 viteve, në vitin 1973 në shkollën fillore "Meto Bajraktari" në Mitrovicë hapën dy paralele speciale, ndërsa në vitin 1984 vepronin 12 paralele të tilla me 138 nxënës.

Numri i shkollave dhe i klasave speciale për çdo vit shtojë, sidomos numri i nxënësve, kështu në vitin shkollor 1974/75 në Kosovë kanë vepruar këto shkolla dhe paralele speciale:

1. Paralelja e shkollës fillore "Bora Vukmiroviq" pranë spitalit antiturbekuloz në Pejë me 16 nxënës dhe një arsimtar;
2. Paralelja pranë shkollës fillore "Vuk Karagjiqi" e nxënësve shurdhmemecë në Prizren me 9 nxënës dhe 2 arsimtarë;
3. Paralelja speciale e shkollës fillore "Emin Duraku" pranë sanatoriumit në Kaçanik me 36 nxënës dhe një arsimtar;
4. Paralelja speciale pranë shkollës fillore "17 Nëntori" në Prizren me 23 nxënës dhe 4 arsimtarë;
5. Qendra shkollore "Spiro Mojsiq" për rehabilitimin e personave me të meta të dëgjimit dhe të folurit në Prizren me 69 nxënës dhe 25 arsimtarë;
6. Shkolla speciale për punëtorë të kualifikuar pranë qendrës "S. Mojsiq" me 42 nxënës dhe
7. Shkolla fillore speciale për fëmijë dhe të rinjtë e verbër dhe gjysmë të verbër në Prishtinë me 36 nxënës dhe 7 arsimtarë.⁶

Në vitin shkollor 1975/76 punonin dy shkolla speciale dhe katër paralele në kuadër të shkollave fillore me gjithsej 42 paralele dhe 248 nxënës. Ky lloj edukimi dhe arsimit ballafaqohej me probleme të shumta, si me mungesë të lokalit mësimor ashtu edhe me mungesë të personelit edukativ e arsimor dhe sidomos me tekste mësimore.

⁵ Historiku i shkurtër i shkollës fillore "Elena Gjika". 2005

⁶ Vetëqeverisëse e Interesit për Arsim dhe Edukim. Programi afatmësëm i zhvillimit të arsimit dhe edukimit në KSA të Kosovës (1976-1980). Prishtinë, tetor 1976

⁷ Bashkësia Krahinore Vetëqeverisëse e Interesit për Arsim dhe Edukim. Programi afatmësëm i zhvillimit të arsimit dhe edukimit në KSA të Kosovës (1976-1980). Prishtinë, tetor 1976, fq. 9

“Zgjidhjet themelore strategjike për ndërtimin e sistemit të arsimit e të edukimit tek ne të definuara në dokumentet e përmendura dhe në Ligjin mbi arsimin dhe edukimin special⁸ si dhe duke u bazuar në të arriturat e verifikuar në pikëpamje profesionale mbi mundësitë e arsimit e të edukimit të personave me të meta në zhvillim kanë bërë që në këtë konceptcion të parashihen forma të ndryshme organizative të arsimit e të edukimit të tyre varësisht nga mundësitë psiko-fizike me të cilat disponojnë”.⁹

Në edukimin dhe arsimin parashkollor special edhe pse edukimi dhe arsimit parafillosor ishin pjesë e sistemit të arsimit në përgjithësi, deri në vitin shkollor 1975/76 nuk ishte bërë asgjë. Nuk ishte formuar asnjë paralele e tillë në nivel të Kosovës. Fëmijët e tillë kishin ngelur në fatin e askujt. Në këtë kishin ndikuar bindja e gabuar e shoqërisë dhe sidomos e familjeve tona se edukimi parashkollor nuk është aq i rëndësishëm dhe as i domosdoshëm. Përveç kësaj nuk kishte institucione që do të bënin sistemin dhe strehimin e tyre.

Numri i fëmijëve me pengesa të ndryshme në Kosovë ishte i madh, ndërsa numri i tyre i përfshirë në edukim institucional ishte i vogël. Në arsimin fillore special në vitin shkollor 1977/78 në nivel të Kosovës ishin të përfshirë 287 nxënës të moshës 7-14 vjeçe,¹⁰ çka do të thotë se përfshirja e tyre në arsimin dhe edukimin special ishte nën çdo nivel.

Kategorizimi i fëmijëve me të meta në zhvillim	Gjithsej fëmijë	Përfshirja e fëmijëve	Përqindja e përfshirjes
1.Fëmijët e shurdhër dhe gjysmë të shurdhër	743	141	18,97
2. Fëmijët e verbër dhe gjysmë të verbër	446	26	5,83
3.Fëmijë të prapambetur mentalisht	2.974	102	3,42
4.Fëmijët invalidë	892	18	2,02
5.Fëmijët me çrregullim në të folur	2.974	0	0
6.Fëmijët e lënë pas dore	892	0	0
Gjithsej	8.921	287	3,22

Në bazë të dhënave të prezantuara në këtë tabelë mund të shihet së numri i fëmijëve me pengesa të ndryshme në zhvillim ishte mjaft i madh, 8.921 fëmijë kishin pengesa të ndryshme, mirëpo të përfshirë në edukimin dhe arsimin adekuat ishin vetëm 287 sish apo 3,22 për qind nga numri i përgjithshëm. Numri dhe përqindja më e lartë e fëmijëve të përfshirë në edukimin dhe arsimin fillore ishte për fëmijë me pengesa në të dëgjuar,

⁸ Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 50/76

⁹ Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe Edukimit: Konceptioni i arsimit dhe edukimit të personave me të meta në zhvillim në KSA të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 1979, fq. 1 (punimi i ka 61 fq.)

¹⁰ Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe Edukimit: Konceptioni i arsimit dhe edukimit të personave me të meta në zhvillim në KSA të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 1979

kurse nuk kishte edukim dhe arsim adekuat për fëmijë me çrregullime në të folur dhe për fëmijë të lënë pas dore.

Me këta fëmijë ka punuar kjo strukturë kualifikuese e mësimdhënësve:

Sektorët e arsimit special	Gjithsej mësimdhënës		Të kualifikuar		Të pakualifikuar	
1. Arsimimi i shurdhërve	36	100.0%	24	66.67%	12	33.33%
2. Arsimimi i të verbërve	11	100.0%	0	0.00%	11	100.0%
3. Arsimi i fëmijëve me të meta të vogla mentale	9	100.0%	7	77.78%	2	22.22%
Gjithsej	56	100.0%	31	55.36%	25	44.64%

Krahas arsimit dhe edukimit fillorë, në vitet e tetëdhjeta hapen edhe shkollat e mesme speciale, në të cilat këta të rinj kishin mundësi të aftësoheshin për profesionet e shkallës dytë dhe të tretë të përgatitjes profesionale.

Në shkollën e mesme për të verbër në Pejë ishin të përfshirë 7 nxënës në klasën në profesionin e telefonistëve.¹¹

Në Kosovë përveç shkollave të lartpërmendura kanë vepruar edhe një shkollë për fëmijë të retarduar në Prizren si dhe disa paralele për fëmijë me retardime të lehta në kuadër të shkollave fillore në Prishtinë, në Mitrovicë, në Gjakovë (2 shkolla fillore, njëra për fëmijë me retardime të lehta mentale, në vitin shkollor 1978/79 dhe tjetra në vitin shkollor 1981/82), në Pejë (për fëmijë me retardime të lehta mentale në vitin shkollor 1978/79), në Gjilan (në vitin shkollor 1989/90, etj). Në shkollat fillore të cilat kishin klasa (tani quhen të bashkangjitura) të tilla nuk ishin të përhershme. Ato në një shkollë vepronin për disa vite, pastaj hapeshin klasa të bashkangjitura në shkolla tjera.

Në vitin 1976 në Prishtinë, në kuadër të shkollës fillore “Vlladimir Nazorij” hapën një paralele speciale me 14 nxënës, ndërsa në vitin 1984 vepron një paralele e kombinuar me 9 nxënës.

Në vitin Shkollor 1984/85 në Kosovë në edukimin dhe arsimin fillor ishin të përfshirë 513 fëmijë.¹² Shkalla e përfshirjes së gjeneratës prej 9.358 fëmijëve ishte arritur të jetë 5,48 %, që do të thotë së është rritur shkalla e përfshirjes së gjeneratës prej 3,22 në 5.58, por edhe më tutje ishte shumë larg mesatares në ish-Jugosllavi.

Në vitin Shkollor 1978/79 në kuadër të shkollës fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë formohet një paralele me 16 nxënës, ndërsa në vitin 1984 ka tri paralele të tilla me 46 nxënës. Në vitin 1982 në kuadër të shkollës fillore “Voja Lakceviq” fillon puna me një paralele speciale me 11 nxënës, sa kishte edhe në vitin 1984.

¹¹ Pokrajinski zavod za vnapredjivanje obrazovanja i vaspitanja, Informacija o aktuelnim problemima specijalnog osnovnog i srednjeg obrazovanja u SAP Kosovu, Pristina, 1984, fq.21

¹² Srednjorocni plan razvoja obrazovanja i vaspitanja u SAP Kosovu za period 1981-1985, Pristina, 1981

Në Pejë në vitin shkollor 1980/81 në kuadër të shkollës fillore “Ramiz Sadiku” formohen 3 paralele me 20 nxënës.

Në bazë të analizave të Entit Pedagogjik të Kosovës del se në vitin shkollor 1984/85 në edukimin dhe arsimin fillor special në kuadër të shkollave fillore ishin të përfshirë 211 fëmijë me pengesa të lehta në zhvillim, përkatësisht me retardime të lehta mentale.¹³

Në shkollën fillore “Emin Duraku” kishte një paralele për nxënës me të meta të lehta mentale. Me këta nxënës punonte një pedagog-psikolog.

Në shkollat fillore speciale punonin 36 mësime, prej të cilëve 9 defektologë me fakultete përkatëse.

Shkollat speciale në Kosovë në vitet tetëdhjeta ballafaqoheshin me shumë probleme, ndërsa ato veçoheshin:

1. Problem ishte kategorizimi i fëmijëve. Në shkolla fillore nuk kishte ekspertë të cilët do të bënin kategorizimin e fëmijëve. Kategorizimi i fëmijëve bëhej me kërkesë të prindërve;
2. Nuk ekzistonte asnjë formë e përfshirjes së fëmijëve në edukimin dhe arsimin parashkollor;
3. Numri i paraleleve speciale në kuadër të shkollave fillore është shumë i vogël;
4. Mungojnë tekstet shkollore adekuate;
5. Mungonte kuadri adekuat mësimes;
6. Mungonin mjetet adekuate mësimore.¹⁴

Tekstet mësimore

Teksteve mësimore të shkollave speciale shumë pak i është kushtuar kujdes ose shumë pak kanë arritur të sigurojnë tekste adekuate në gjuhën shqipe. Kjo për faktin së numri i fëmijëve të përfshirë në shkollat speciale është i vogël por edhe për shkak të mungesës së ekspertëve të hartimit të teksteve për këtë fushë. Në gjuhën shqipe në vitin shkollor 1984/85 nuk kishte fare tekste, ndërsa në gjuhën serbe përdoreshin disa tekste të hartuara në Beograd, por që kishte pengesa në zbatimin e tyre meqë ato nuk përkonin me planet dhe programet mësimore të Kosovës.¹⁵ Për fëmijë me pengesa në dëgjim nuk kishte asnjë tekst adekuat sipas alfabetit të Brajtit, kurse për ata me pengesa në shikim kishte vetëm një Abetare dhe një Lexim për klasën e dytë.

13 Pokrajinski zavod za unapredjivanje obrazovanja i vaspitanja, Informacija o aktuelnim problemima specijalnog osnovnog i srednjeg obrazovanja u SAP Kosovu, Pristina, 1984, fq.11

14 Pokrajinski zavod za unapredjivanje obrazovanja i vaspitanja, Informacija o aktuelnim problemima specijalnog osnovnog i srednjeg obrazovanja u SAP Kosovu, Pristina, 1984, fq.13

15 Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe të Edukimit, Informatë mbi gjendjen, nevojën dhe mundësitë e botimit të teksteve dhe mjeteve mësimore për arsimin dhe edukimin special në KSA të Kosovës, Prishtinë, 1985, fq. 4

Pas Luftës së fundit janë bërë dhe po bëhen përpjekje që të sigurohen tekstet adekuate në mënyrën elektronike. Tekstet bazë të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme të ulëta janë digjitalizuar nga ekspertet e shkollave përkatëse. sidomos për shkollën speciale për të verbër në Pejë.

Shkollat speciale që vepronin dhe që veprojnë në Kosovë

Edukimi dhe arsimiti i fëmijëve të verbër

Në vitin shkollor 1968/69 në arsimin special për fëmijë të verbër ekzistonte shkolla e themeluar në vitin 1950 në Mitrovicë dhe e transferuar më vonë në Prizren me 120 nxënës, prej të cilëve 49 shqiptarë, 3 turq dhe të tjerët serbë e malazias. Përveç kësaj veprojnë edhe 3 paralele për fëmijë shurdhmemec pranë shkollës fillore "V. Karagjiq" në Prishtinë me 28 nxënës, prej të cilëve 16 shqiptarë dhe 12 serbë. Jashtë Kosovës ishin të përfshirë 15 fëmijë, prej të cilëve 5 shqiptarë.¹⁶

Konvikti i parë për të verbër është çelur në Mitrovicë 11 tetor të vitit 1953 me nisjavën e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës. Qëllimi i këtij konvikti ishte që të aftësohen të verbëritë të të dy gjinive të moshës prej 14 deri në 45 vjeçe. Konvikti kishte godinën e vet me 6 dhoma në të cilin kishte mundësi të sistemimi maksimalisht 25 fëmijë. Të rinjtë e sistemuar në këtë konvikte apo strehimore nuk kishin plan dhe program të caktuar për klasa dhe nivele të shkollimit. Ata mësonin sipas alfabetit të Brajnit vetëm në gjuhën serbe. Personeli edukativ nuk mbante evidencë të punës pedagogjike. Biblioteka e konviktit kishte gjithsej 53 libra artistike dhe 45 libra shkencorë.¹⁷ Deri në këtë vit të gjithë fëmijët shqiptarë dhe serbë të Kosovës kishin mundësi të arsimoheshin vetëm në Zemun (qytet i Serbisë), në të cilin qytet shkolla speciale për fëmijë të verbëritë kishte traditë relativisht të gjatë. Meqë në Kosovë nuk kishte shkollë të tillë atëherë janë organizuar kurse në të cilat fëmijët do të mësonin në bazë të alfabetit të Brajnit i cili në gjuhën serbe ekzistonte, ishte adaptuar dhe përshtatur kësaj gjuhe, ndërsa në gjuhën shqipe deri në vitin 1965 për fëmijë shqiptarë ishte i panjohur dhe i pamundshëm për zbatim.¹⁸

Prej vitit 1950 deri në vitin 1959 u organizuan mëse 17 kurse për analfabet, por me pak sukses. Edhe pse numri i vijuesve në këto kurse ishte relativisht i madh, numri i atyre që mësuuan alfabetin e Brajnit ishte i vogël, vetëm 43 prej tyre mësuuan shkrim-leximin me sukses dhe atë në gjuhën serbe. Në vitet 1962-1963 një kurs për analfabet ishte organizuar edhe në Pejë, në të cilin ishin përfshi 13 fëmijë të verbër.

16 Arkivi i Kosovës, Fondi: Bashkësia Krahinore e Arsimit, kutia 29. 1969-1970

17 Arkivi i Kosovës, fondi: Sekretariatit za prosvetu i kulturu, kutia 16. A. 1955

18 Bajram Shatri, Arsimiti fillor në Kosovë në shekullin XX, sfida, dëshmi, fakte I, Prishtinë, 2006, fq.492

Në vitin shkollor 1964/65 shoqata nuk kishte patur ndonjë aktivitet. Në këtë vit nga Kosova ishin të përfshirë në shkollën speciale të Zemunit 20 fëmijë.

Falë këmbëngulësisë së Faik Halilit dhe Tajar Hatipit në vitin 1965 ishte hartuar alfabeti i gjuhës shqipe i mbështetur në alfabetit e Brajtit. Ky ishte një kontribut i jashtëzakonshëm dhe humanitar për fëmijët e verbër shqiptarë. Tek pas këtij viti fillon intensifikimi i përpjekjeve për çeljen e shkollës speciale për fëmijë të verbër.¹⁹

Shkolla e parë e edukimit dhe arsimit special me fëmijë me pengesa në të pamur ka filluar në Mitrovicë në vitin shkollor 1968/69 me 24 fëmijë në klasën e parë të shkollës fillore, prej të cilëve 6 ishin nga Prishtina, 7 nga Mitrovica, 3 nga Istogu dhe Prizreni si dhe 5 fëmijë nga Peja. Në vitin shkollor 1968/69 në Mitrovicë ka filluar puna me edukimin dhe arsimin special në një objekt barake në Fabrikën e ish-Supërfosfatit. Shkolla e parë u ballafaqua me probleme të shumta sepse nuk kishte as lokal të mjaftueshëm mësimor por as kuadër të kualifikuar mësimor. Shkolla ishte e tipit konviktor nxënësit e së cilës ishin të sistemuar në te.

Paralelet speciale për fëmijë të verbër janë hapur dhe punonin në kuadër të shkollës së rregullt fillore “17 Nëntori” të Prizrenit që nga viti shkollor 1974/75, kurse prej 27 prillit të vitit 1982 e këndeje kjo shkollë speciale për edukimin dhe arsimin e fëmijëve dhe të rinisë së verbër dhe gjysmë të verbër me konviktor punon në Pejë. Në këtë shkollë speciale në Pejë vepronin:

- një paralele e klasës parë dhe të dytë me 4 nxënës,
 - një paralele e klasës parë me 11 nxënës,
 - një paralele e kombinuar e klasave II dhe IV me 9 nxënës,
 - një paralele e klasës III me 9 nxënës,
 - një paralele e kombinuar e klasave V-VII me 12 nxënës,
- një paralele e klasës I-rë të arsimit të mesëm të orientuar me 7 nxënës

Prej vitit 1981 të gjithë nxënësit kalojnë në Pejë, e cila kishte 52 nxënës.²⁰

Në këtë shkollë speciale, në vitin shkollor 1982/83 kishte gjithsej 48 nxënës. Këta nxënës ishin të sistemuar në ndërtesën e shkollës së re me konviktor. Kushtet e punës ishin mjaft të mira. Shkolla ishte e pajisur me kabinetet dhe mësonjëtoje të specializuara.²¹

Në vitin Shkollor 1988/89 shkolla speciale e të verbërve në Pejë kishte 46 nxënës me 10 paralele.

¹⁹ Dr. Fehmi Pushkollit, Zivot i rad slepih Kosova, Prishtinë, 1978, fq. 167

²⁰ Pokrajinski zavod za unapredjivanje obrazovanja i vaspitanja, Informacija o aktuelnim problemima specijalnog osnovnog i srednjeg obrazovanja u SAP Kosovu, Pristina, 1984, fq. 16

²¹ Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe të Edukimit, Gjendja dhe problemet e edukimit dhe të arsimit të fëmijëve të metë në zhvillimin psikofizik në KSA të Kosovës m,e propozimin e masave, Prishtinë, 1983, fq. 11-12

Në vitin shkollor 1989/90, një vit para së të aplikoheshin masat e dhunshme në arsimin shqip, kjo shkollë kishte këtë strukturë të nxënësve në arsimin e mesëm:

Qendrat shkollore	Kl.	Shqip		Serbisht		Gjithsej	
		Par.	Nx.	Par.	Nx.	Par.	Nx.
Qendra shkollore për fëmijë të verbër - Pejë	I	1	9	1	3	2	12
	II	1	7	1	2	2	9
	III	1	1			1	11
	IV	1	6			1	6
	Gj.	4	33	2	5	6	38

Gjatë viteve të nëntëdhjeta nxënësit dhe mësimsdhënësit shqiptarë kanë punuar në objektin e tyre shkollor, meqë nuk është bërë presion ndaj tyre që të largohen nga objekti shkollor.

Shkolla fillore për fëmijë me retardime mentale "Lef Nosi" në Prizren

Fillet e kësaj shkolle datojnë në vitin 1968 kur për herë të parë në lokalet e shkollës fillore "17 Nëntori" (tani "Matia Logoreci") hapën paralele për fëmijë me retardime të lehta mentale, ndërsa prej vitit 1973 kjo shkollë punon si shkollë e pavarur me subjektivitet juridik, si Shkollë Speciale për Fëmijë dhe të Rinj me të Meta Psiko-Fizike.

Në këtë shkollë, në fillim të viteve të tetëdhjeta, fëmijët ishin të sistemuar në godinën shkollore të ngritur enkas për fëmijë të tillë dhe kishte edhe konviktin për sistemimin e fëmijëve. Ishin të angazhuar 10 mësimsdhënës, prej tyre 4 defektologë. Procesi mësimor zhvillohej në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Në fillim nuk shfrytëzohej konvikti i fëmijëve meqë të gjithë nxënësit ishin nga territori i komunës së Prizrenit, ndërsa më vonë në këtë shkollë përfshihet një numër i konsideruar i fëmijëve nga tërë territori i Kosovës, nga Maqedonia dhe viset tjera të ish-Jugosllavisë.

Prej vitit 1986 e deri me sot kjo shkollë është shndërruar në Qendër për Arsimimin dhe Edukimin e Fëmijëve dhe të Rinjve me të Meta Psiko-Fizike të tipit konviktor.²² Në vitin shkollor 1988/89 kjo shkollë kishte 71 nxënës me 14 paralele.

Në arsimin e mesëm në vitin shkollor 1989/90 shkolla kishte këtë strukturë të nxënësve:

²² Iljaz Krasniqi. Historiku i shkollës. Prizren, janar 2004

Qendrat shkollore	Kl.	Shqip		Serbisht		Gjithsej	
		Par.	Nx.	Par.	Nx.	Par.	Nx.
Qendra shkollore për fëmijë të retarduar - Prizren	I	1	6	1	3	2	9
	II	1	12			1	12
	III	1	12			1	12
	IV	1	5	1	1	2	6
	Gj.	4	35	2	4	6	39

Edhe kjo shkollë e ndanë fatin e shumë shkollave tjera të Kosovës në të cilat u aplikuan masat e dhunshme në fillim të dekadës së nëntë të shekullit të kaluar. Në vitin shkollor 1991/92 shkolla kishte 52 nxënës të shpërndarë në 8 paralele prej klasës së I-rë deri në klasën VIII. Drejtori serb Petar Martinoviq më 3 tetor të vitit 1991 kishte larguar nga shkolla 3 edukatore, me motivacion së nuk punojnë dhe nuk i pranojnë planet dhe programet mësimore të Serbisë.

Në vitin 1999, pas bombardimeve të forcave të NATO-s në këtë shkollë të tipit konviktor ishin sistemuar forcat ushtarake dhe policore serbe për t'u kamufluar.²³

Pas Luftës së fundit shkolla udhëhiqet nga personeli edukativ-arsimor dhe administrative shqiptarë nën udhëheqjen e drejtorit Iljaz Krasniqi.

Shkolla e mesme "Spiro Mojsiq" në Prizren (1991/92)

Shkolla e parë speciale (konvikti) për fëmijë dhe rini me pengesa në të dëgjuar është themeluar në Mitrovicë në vitin 1950. Një vit pas themelimit, në vitin 1951 shkolla transferohet në Prizren ku punon edhe tani (në vitin 2012). Shkolla në Prizren kishte objektin e vet si dhe konviktin, në të cilin ishin të sistemuar nxënësit jashtë territorit të komunës së Prizrenit.

Para së të hapet shkolla speciale për shurdhmemec në Mitrovicë çetel konvikti për fëmijë shurdhmemec në të cilën do të përfshihen fëmijët dhe të rinjtë e moshës 7 deri në moshën 30 vjeçe. Ky konvikti ishte çelur me nisjativën e Shoqatës së Shurdhmemecëve të Kosovës dhe ishte i një tipi të përzier.²⁴ Mirëpo, së shpejti kjo shkollë transferohet në Prizren meqë kushtet e strehimit dhe të shkollës ishin mjaft të pavolitshme në Mitrovicë. Në Prizren këta nxënës sistemohen në një objekt të shkollës fillore, e cila shkollë kishte disa nxënës shurdhmemec. Në vitin shkollor 1951/52 në Shkollën Speciale për Shurdhmemecë në Prizren përfshihen 12 nxënës, të cilët ishin regjistruar në klasën e parë. Në mbarim të vitit shkollor 1952/53 shkolla kishte 28 nxënës, prej tyre 20 në klasë të parë dhe 8 në klasë të

²³ Po aty

²⁴ Stanislav Stavretoviq & Dr. Gjorgje Stavretoviq, Razvoj skolstva za gluve na Kosovu i Metohiji, revista serbe e IHK, Kosmet 1, Prishtinë, 1991, fq. 318

dytë.²⁵ Në vitet vijuese bëhet regjistrimi dhe përfshirja e fëmijëve edhe në klasën II, III dhe IV.

Kështu në mënyrë suksesive bëhet shtimi i numrit të nxënësve dhe vijimi i tyre në klasat tjera të ciklit të lartë. Gjenerata e parë e nxënësve që kanë kryer klasën e VIII të shkollës fillore doli në vitin shkollor 1958/59.

Objekti i ri shkollor me konvikt i dedikuar enkas për nxënës të kësaj shkolle është ngritur në vitin 1959 dhe në vitin shkollor 1959/60 në këtë vit shkollor shkolla kishte rreth 60 nxënës të nacionaliteteve të ndryshme nga anekënd Kosovës. Kati i parë ishte i dedikuar për mësim ditor, kurse kati i dytë ishte dedikuar strehimit të këtyre fëmijëve.

Në vitin shkollor 1962/63 në shkollën e shurdhmemecëve në Prizren ishin të përfshirë 79 fëmijë. Ky numër i fëmijëve ishte shumë i vogël në krahasim me numrin e fëmijëve të cilët mund të përfshiheshin, mirëpo kishte probleme të theksuara nëpër komuna dhe entet përkatëse në përcaktimin e fëmijëve të cilët do të duhej të ndjekin shkollën speciale.²⁶

Në vitin 1974, Shkolla e Mesme Speciale për nxënësit shurdhmemec në Mitrovicë, definitivisht u shua në bazë të vendimit të Kuvendit të KSA Kosovës meqë nuk kishte më as nxënës dhe as kushte elementare për punë. Me të njëjtin vendim u transformua edhe shkolla speciale për fëmijë të verbër "Migjeni" në Prishtinë. Nxënësit e kësaj shkolle u transferuan në Prizren pranë shkollës speciale të fëmijëve me të meta mentale

Në vitin 1984 edukimin dhe arsimin fillor special e ndiqnin 165 nxënës. Procesi mësimor ishte i organizuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Këta nxënës ishin të përfshirë prej klasës parë deri në klasën e tetë.

Qendra shkollore "Spiro Mojsiq" në Prizren është themeluar në vitin 1973. Shkolla ishte e tipit konviktore me rreth 100 shtretër. Qendra shkollore kishte të përfshirë edhe nxënës të arsimit të mesëm. Në vitin 1987 në shkollë kishte 129 nxënës. Vijues kishte nga të gjitha viset shqiptare të ish-Jugosllavisë.²⁷ Prej tyre në arsimin e mesëm ishin të përfshirë rreth 60 nxënës prej vitit të parë deri në klasën e katërt në këto profesione: tekstilit-konfeksioner; përpunimi i drurit – zdrukthëtar dhe përpunues i lëkurës – këpucëtar.

Në vitin shkollor 1988/89 në tri shkolla speciale ishin të përfshirë 254 nxënës me gjithsej 43 paralele dhe me mesatare prej 6 nxënësve në paralele. Në vitin shkollor 1988/89 Shkolla speciale për shurdhmemec në Prizren kishte 137 nxënës të shpërndarë në 19 paralele.²⁸

25 Arkivi i Kosovës. Pleqësia për Arsim dhe Kulturë, kutia 1 1953

26 Arkivi i Kosovës. Fondi: Savet za prosvetu i kulturu 1954-1960.

27 Arkivi i Kosovës. Fondi: Sekretariati Krahinore për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, kutia, 28; Po aty, fq. 7-8

28 Bashkësia Krahinore Vetëqeverisëse e Interesit të Arsimit dhe të Edukimit. Raporti i regjistrimit të nxënësve dhe të studentëve në fillim të vitit Shkollor 1988/89 në KSA të Kosovës, Prishtinë, 1988, fq. 16

Në vitin shkollor 1989/90 shkolla kishte këtë strukturë të nxënësve të arsimit të mesëm:

Qendrat shkollore	Kl.	Shqip		Serbisht		Gjithsej	
		Par.	Nx.	Par.	Nx.	Par.	Nx.
Spiro Mojsiq – Prizren	I	2	10	1	3	3	13
	II	1	9	1	7	2	16
	III	1	12	1	3	2	15
	Gj.	4	31	3	13	7	44

Në vitin shkollor 1990/91 Qendra shkollor është e tipit konviktor dhe përbëhej nga dy objekte me sipërfaqe prej 1944 mk. Konvikti kishte gjithsej 851 mk të sipërfaqes së shfrytëzueshme me 9 dhoma fjetjeje me dhomën për qëndrim ditor, ambulanten, trapezarinë dhe depon. Masat e dhunshme ishin aplikuar më 4 janar 1991. Me këtë rast nga procesi i punës ishin larguar me dhunë 25 punëtorë, prej tyre 17 punëtorë të arsimit: 3 profesorë defektologë, një arsimtar defektolog (në marrëdhënie të përhershme pune: psikologu, pedagogu, logopedi, punëtori social etj., si dhe drejtori i shkollës i cili nuk i kishte pranuar masat e dhunshme administrative.²⁹ Sipas raportit të inspektoratit të arsimit të strukturave serbe që punuan në Kosovë, në këtë qendër shkollore kishte edhe nxënës shqiptarë nga mbarë Kosovë, ndërsa mësimdhënësit shqiptarë që nuk i kishin pranuar planet dhe programet e Serbisë e që ishin larguar me dhunë nga qendra shkollor ishin zëvendësuar me mësimdhënësit tjerë shqiptarë.³⁰

Në këtë vit shkollor në procesin mësimor ishin të përfshirë 157 nxënës në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Këta nxënës ishin të shkollës fillore dhe të shkollës së mesme. Në shkollën fillore ishin të përfshirë 91 nxënës shqiptarë të shpërndarë në 10 paralele, kurse në arsimin e mesëm ishin të përfshirë 26 nxënës. Në gjuhën serbe kishte më pak nxënës. Në shkollën fillore kishte 20 nxënës dhe në arsimin e mesëm 9 nxënës.³¹

Edhe në këtë shkollë, sikurse në të gjitha shkollat fillore dhe shkollat e mesme të Kosovës, në vitin 1990 ishin aplikuar masat e dhunshme. Më 28 dhjetor të vitit 1990 në vend të drejtorit shqiptar Agim Skoro ishte emëruar drejtori i dhunshëm Milorad Peiq. Objekti shkollor është uzurpuar nga serbët më 4 janar 1991 duke u krijuar trazira të mëdha në shkollë. Shkolla në këtë vit kishte gjithsej 167 nxënës (duke përfshirë edhe shkollën e mesme), prej të cilëve shqiptarë shin 138 sish apo 82,63 nga numri i përgjithshëm i nxënësve. Prej këtij viti dhe gjatë viteve të nëntëdhjeta një pjesë e nxënësve shqiptarë kishin ngelur në shkollën përkatëse, ndërsa pjesa më e madhe e mësimdhënëësve shqiptarë u larguan me dhunë nga

29 Arkivi i Kosovës, fondi: Enti Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit, kutia 63/1991/92

30 Po aty

31 Po aty

shkolla. Në vend të tyre drejtorja e dhunshme kishte pranuar mësimdhënës të ri. Nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë të larguar nga objekti shkollor u sistemuan në lokale tjera shkollore, por nxënës të komunave të tjera më nuk kishte sepse nuk kishin kushte për strehim.

Në vitin shkollor 1999/2000 nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë të larguar u kthyen në lokalet e veta mësimore dhe strehimore. Për ndryshim të paraluftës tani në këtë shkollë nuk ka nxënës në gjuhën serbe.

*Shkolla fillore speciale për fëmijë me retardime mentale
"Përparimi" në Prishtinë*

Kjo shkollë është themeluar më 15 tetor 1985. Edhe pse prej themelimit veprimi si shkollë e pavarur ajo deri në vitin 2011 nuk kishte lokal të vetin. Në mungesë të lokalit ajo ishte sistemuar në lokalet e shkollës fillore "Vlladimir Nazor", tani "Naim Frashëri". Në këtë objekt të shkollës fillore ishin ndarë 2 mësonjëtoje me hyrje të veçantë për nxënës e shkollës speciale. Në ndërkohë këto dy mësonjëtoje modifikohen dhe vihen 4 dhoma. Në këto mësonjëtoje bëhej edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me retardime të lehta mentale prej klasës së I-rë deri në klasën VIII.³²

Masat e dhunshme në këtë shkollë ishin aplikuar në vitin 1991. Në vend të drejtorit shqiptar Beqir Selmani ishte emëruar drejtoresha e dhunshme serbe Verica Ristiç. Verica ishte drejtoreshë e dhunshme edhe në shkollën fillore "Naim Frashëri". Mirëpo nxënësit dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle gjithnjë kanë punuar në objektin shkollor gjatë gjithë periudhës së viteve 1991-1999 me përjashtim të një pauze të shkurtër prej 10 ditësh në shtator të vitit 1991. Shkolla kishte 7 edukatore, prej tyre 5 shqiptare.

Shkolla nuk kishte objekt dhe konvikt të vetin, andaj nxënësit e shkollës janë transportuar në mënyrë të organizuar në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas. Në mungesë të mjeteve të transportit gjatë viteve të nëntëdhjeta numri i nxënësve kishte rënë, por ky numër kishte rënë edhe për faktin së shumica e prindërve të këtyre nxënësve ishin larguar nga procesi i punës.³³

³² Igballe Potera, drejtoreshë e kësaj shkolle. Historiku i shkurtër i shkollës, shtator 2012

³³ Po aty

*Qendra edukative-arsimore për fëmijë dhe rini me nevoja të veçanta
"Nëna Tereza" në Mitrovicë*

Fillet e kësaj shkolle datojnë nga viti 1974, kur në kuadër të shkollës fillore "Meto Bajraktari" në Mitrovicë për herë të parë hapën 4 paralele për fëmijë me të meta të lehta mentale, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën serbe. Këto paralele kanë vepruar deri në vitin 1984 kur themelohet një qendër e re shkollore për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinisë shkollore. Prej themelimit të qendrës kishte nxënës edhe nga komunat fqinjë, kryesisht nga Vushtrria dhe Skenderaj. Shkolla kishte objektin e vet të adaptuar me 5 mësonjëtoare dhe objektet tjera përcjellëse. Në këtë shkollë ishin të përfshirë nxënësit që nga klasa e parë deri në klasën e katërt. Numri i nxënësve sillej rreth 60 deri në 70 nxënës. Pjesa dhe përqindja më e madhe e tyre ishte në gjuhën shqipe rreth 75 % nga numri i përgjithshëm i nxënësve. Në kuadër të kësaj qendre ishin të përfshirë edhe rreth 20 nxënës në arsimin e mesëm.³⁴

Gjatë viteve të '90-ta për ndryshim nga shkollat tjera nxënësit dhe mësimdhënësit e saj shqiptarë kanë punuar në objektin e tyre Shkollor. Drejtoreshë shkolle edhe më parë ishte Miroslava Popoviq, ndërsa si përgjegjës apo drejtor për nxënës dhe mësimdhënëës shqiptar nga organet e administratës shqiptare gjatë viteve 1991-1999 ishte caktuar Hajdar Shyti, i cili financohej nga Këshilli Komunal i Financimit.

Prej vitit shkollor 1999/2000 nxënësit dhe mësimdhënësit serbë janë tërhequr dhe bashkë me ta edhe i tërë inventari i shkollës ishte bartur në pjesën veriore të Mitrovicës.

Shtëpia edukuese korrektuese "Jeta e Re" në Lipjan

Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar në kuadër të Shtëpisë korrektuese ka vepruar edhe shkolla për të mitur, e cila kishte për qëllim aftësimin e të miturve për jetë. Edhe kjo shkollë nuk i shpëtoi ndëshkimeve që iu bënë arsimit shqip në përgjithësi gjatë viteve të nëntëdhjeta. Edhe pse drejtor i kësaj shtëpie ishte serbi Millosh Petkoviq, i cili deri në këtë kohë ishte shumë i afërt dhe "miqësor" me punëtorët dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle, në vitin 1990 e tregoi karakterin e tij. Kishte larguar nga puna Shpresa Kuqin, drejtoreshë e burgut të grave, pastaj Izjah Arifin drejtorin e shkollës "Jeta e Re" si dhe dy edukatorë të kësaj shkolle. Këta dhe disa punëtorë të tjerë ishin larguar nga puna për "arsye" së nuk i pranonin planet dhe programet mësimore të Serbisë.³⁵ Megjithatë shkolla ka punuar

³⁴ Historiati i shkurtër i shkollës i hartuar nga drejtori i shkollës Hajdar Shyti.

³⁵ Ismail Rexhepi, Tentojnë që ta mbyllin shkollën, Shkëndija, nr. 32, korrik 1991

në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme. Shkolla punon edhe tani që nga paslufta e deri me sot. Numri i vijuesve të kësaj shkolle vazhdimisht është në lëvizje. Vijuesit e kësaj shkolle aftësohen për profile arsimore të shkallës së III të përgatitjes profesionale të lëmive prodhuese e teknike.

Arsimi special dhe gjithëpërfshirja në vitet 2000/2012

Arsimi special në periudhën e pasluftës i është dhënë rëndësi e veçantë dhe janë bërë përpjekje që të përfshihet numri sa më i madh në forma të ndryshme të arsimimit fillore dhe të mesme.

Klasat e bashkangjitura

Klasat e bashkangjitura (para luftës janë quajtur paralelet (klasat) specialet). Në vitin shkollor 2002/03 është filluar me klasën e parë të bashkangjitur duke vazhduar në mënyrë suksesive në klasat tjera të shkollës fillore dhe të shkollës së mesme të ulët dhe kështu gjenerata e parë e nxënësve, që e ka mbaruar shkollën fillore dhe shkollën e mesme të ulët ka kaluar në vitin shkollor 2010/2011. Klasat e bashkangjitura janë formuar në çdo shkollë për të cilat ka patur kushte dhe interesim të nxënësve dhe të prindërve të tyre.

Në vitin shkollor 2004/05 në këtë formë të arsimit dhe të edukimit ishin të përfshirë 434 nxënës, të shpërndarë në 50 paralele.³⁶ Prej vitit në vit numri i nxënësve në klasa të tilla është duke u shtuar vazhdimisht meqë kjo formë e arsimit është treguar e suksesshme. Nxënësit të cilët arrin rezultate në mësim, në klasat e bashkangjitura, në klasat vijuese mund të kalojnë në klasa të mësimt të rregullt.

Në vitin shkollor 2011/2012 në të gjitha komunat e Kosovës ka shkolla, së paku që kanë nga dy paralele të klasave të bashkangjitura. Në këtë formë të edukimit dhe të arsimit në këtë vit shkollor ishin të përfshirë 545 nxënës në 73 paralele të klasave të bashkangjitura.³⁷

Përfshirja – Integrimi / Inkluzioni

Gjithëpërfshirja (inkluzioni) në arsim është formë e re e punës me fëmijë me nevoja të veçanta. Gati në të gjitha shtetet evropiane aplikohet inkluzioni në arsim, sidomos në arsimin fillore dhe të mesëm të ulët.

36 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim, 2004/05, 05.06.06.07, Prishtinë, 2008

37 Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011.2012, Prishtinë, 2012, fq. 33-38

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë organizohet në institucione parashkollore, në shkollat speciale/qendra burimore, klasë të rregullta dhe klasë të bashkëngjitura, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave të rregullta dhe në tre shkolla ku janë të punësuar arsimtarë gjithëpërfshirës (pilot program). Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, viteve të fundit ka shënuar rritje, kështu vetëm në vitin shkollor 2009/2010 numri i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore që marrin mbështetje dhe që janë përfshirë në shkolla fillore dhe në shkolla të mesme të ulëta ka shënuar rritje prej 30% pra, nga 909 fëmijë në vitin shkollor 2011-2012, ka arritur në 1179 fëmijë.

Sistemi aktual i arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore gjithnjë e më tepër po shkon drejt hapjes ndaj arsimit të rregullt, me qëllim që fëmijët me nevoja të veçanta arsimore gjithnjë e më tepër të jenë pjesë e shkollave dhe klasave të rregullta. Viteve të fundit është punuar në ngritjen e kapaciteteve të qendrave burimore në mënyrë që ato të ofrojnë shërbime profesionale për shkollat e rregullta.

Transformimet e shumta që ndodhën në vendin tonë viteve të fundit, patën ndikime të fuqishme edhe në fushën e arsimit me aplikimin e reformave në të gjitha nivelet e arsimit dhe kjo ka sjellë edhe nocione dhe koncepte të reja në trajtimin dhe vendin që duhet të zë arsimit special. Në këtë periudhë, kontribut të çmuar ka dhënë Përkrahja Finlandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë (FSDEK), sidomos në hartimin e politikave për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, trajnimin e ekspertëve, mësimdhënësve etj. Me gjithë arritjet e shënuara në disa fusha ende ka shumë aspekte ku duhet të punohet në mënyrë që të sigurohet gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Të gjitha shkollat janë të obliguara t'i pranojnë të gjithë fëmijët e moshës shkollore pa marrë parasysh gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose ndonjë gjendje tjetër. Kjo duhet të përfshijë fëmijët me aftësi të kufizuar arsimore dhe fëmijët me talent, fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë, fëmijët nga viset e larta dhe popullatat nomade, fëmijët e minoriteteve gjuhësore, etnike ose kulturore dhe fëmijët nga viset apo grupet e marginalizuara.”³⁸

Deri më tani ka ekzistuar praktika e regjistrimit të fëmijëve me dëmtime të lehta në shkollat e rregullta por shkollat kanë qenë plotësisht të papërgatitura sa i përket kuadrit të nevojshëm, sa i përket programit dhe në bazën e përgatitjes teknike për përkrahjen e këtyre nxënësve nuk ka ekzistuar përkrahje sistematike dhe profesionale kurse paragykimet dhe qëndrimet negative kanë paraqitur barriera të mëdha në shkollimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

38 UNESCO (1994), Deklarata e Salamankes dhe korniza për veprim në arsimin me nevoja të veçanta. f. 6.

Ky ndryshim i rëndësishëm në sistemin shkollor në Kosovë, i cili nëpërmjet dispozitave ligjore i jep mundësi të barabarta në arsim të gjithë fëmijëve, nxjerrë në pah edhe shumë nevoja për ndryshim dhe për largimin dilemave, por edhe përgatitjet voluminoze duke filluar prej qëndrimit të mësimdhënësve deri te zbatimi i programit individual arsimor ndaj llojit të dëmtimit, dhe përgatitjes së klasave me mjete të nevojshme didaktike dhe mësimore.

Në Kosovë nga viti shkollor 2009-2010 veprojnë edhe tri shkollat e para të rregullta të cilat janë tani më shkolla gjithëpërfshirëse dhe me mësimdhënës mbështetës: Shkolla fillore "Ismail Qemali" në Prishtinë; Shkolla fillore "Isa Boletini" në Rahovec; Shkolla fillore "Ahmet Delija" në Skenderaj. Qëllimi i punësimit të këtyre mësimdhënësve është për të mbështetur fëmijët më nevoja të veçanta arsimore që janë në klasa të rregullta si dhe përgatitjen e PIA-s (Planeve Individuale të Arsimit) dhe po ashtu të mbështesin stafin e shkollës, udhëheqjen dhe komunitetin në zhvillimin e një shkolle gjithëpërfshirëse.

Tani në këtë vit shkollor 2011-2012 janë gjithsej 17 shkolla gjithëpërfshirëse dhe në secilën shkollë gjithëpërfshirëse janë të punësuar 17 mësimdhënës mbështetës që janë shtysa e parë apo ndihma e parë që merr një shkollë gjithëpërfshirëse. Pesë nga këto shkolla gjithëpërfshirëse janë themeluar dhe mbështeten nga Ministria e Arsimit të Kosovës dhe 12 shkolla të tjera mbështetën nga Projekti "Save the Children" në Prishtinë. Përpos këtyre 17 shkollave gjithëpërfshirëse në Kosovë janë edhe 9 institucione parashkollore gjithëpërfshirëse dhe në secilën prej tyre janë të punësuar edhe nga një mësimdhënës mbështetës.

Në vitin shkollor 2011-2012 janë të përfshirë në arsimin speciale 1179 nxënës me nevoja të veçanta, prej tyre 180 nxënës dhe mësimdhënësit e tyre janë të përkrahur nga mësimdhënësit mbështetës (në shkolla të rregullta fillore dhe shkolla të mesme të ulëta), 454 nxënës janë të përfshirë në 7 shkollat speciale dhe 545 nxënës (mungojnë shënimet për një shkollë speciale në Mitrovicë me nxënës në gjuhën serbe) në 73 klasa të bashkangjitura.³⁹ Në të gjitha këto tipe të shkollave speciale dhe të inkluzionit ishin të punësuar 136 mësimdhënëse dhe edukatore, prej tyre 21 motra medicinale si dhe 53 punët orë tjerë teknik e administrativ.⁴⁰

Sipas vlerësimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë 10% e nxënësve janë nxënës me nevoja të veçanta arsimore që do të thotë së nxënës të tillë në Kosovë janë rreth 40 mijë, ndaj edhe më tutje Kosova nuk ka arritur që t'i përfshijë të gjithë këta nxënës në edukimin dhe arsimin speciale (në shkolla speciale), në arsimin dhe edukimin e klasave të bashkangjitura dhe në paralelet gjithëpërfshirëse me mësues mbështetës.

³⁹ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011-2012, Prishtinë, 2012, fq. 33-38.

⁴⁰ Po aty, fq. 36.

Ma. Saranda SHATRI

SUMMARY

SPECIALIZED EDUCATION IN KOSOVA

Children with disabilities and impaired vision till the early 1950's, from Kosova were sent to the only specialized school of this kind in Zemun, Serbia. Albanian children and adolescents faced with problems at this school for not being familiar to Serbian and Croatian languages, and hardly found adaptation on completely different setting and conditions. Having in mind the urgent need for specialized schools, the Associations of Blind and Deaf people in Kosova initiated request to respective institutions for establishing adequate facilities. As a result of this engagement, initially in Mitrovica in the beginning of 1950's opened the first schools for children with vision and hearing impairment. Nevertheless these were not adequately specialized, but a kind of combination between school and dormitory accommodating children with such needs.

Specialized schools operating in Kosova during the last century were in: Peja for children and youngsters with the vision impairment; special school of the speech and hearing impairment in Prizren; specialized schools for the impairment of intellectual development in Prizren, Prishtina and Mitrovica. Except for the schools of specialized education of children with impairments, classes have been established with children in regular elementary schools. Number of the classes continually increased from 1970's until present.

In Kosova recently are employed six assistant teachers (experts) who assist teaching staff in the educational process. A classroom can accommodate one or two children with special needs.